

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7080
E mërkurë, 27 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Avokati i Popullit: Ligjin
për Zgjedhje do ta dërgojmë
në Kushtetuese | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA E QUAN "PROPAGANDË TË LODHUR" SONDAZHIN QË LV-në E NXORI FITUESE, I KËRKON KURTIT BALLAFAQIM NË ZGJEDHJE | FAQE 4-5



Në kohën kur po flitet mundësia për zgjedhje të parakohshme në vend, ka nisur edhe realizimi i sondazheve të ndryshme për të parë se si qëndrojnë partitë politike. Një sondazh i tillë është realizuar së fundmi nga UBO Consulting, sipas të cilit, Lëvizja

Vetëvendosje kryeson në vend të parë me 48.5 %, e dyta është Partia Demokratike e Kosovës me 18.2 %, e treta Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.9 %. Pas këtyre partive pason AAK-ja me 6.8 për qind. Ndaj këtij sondazhi ka pasur reagime të

deputetëve të LV-së dhe të anëtarëve të saj, të cilët e kanë shpërndarë këtë sondazh në profilet e tyre në rrjetet sociale. Por opozita këtë sondazh e ka quajtur "propagandë të lodhur" dhe i ka kërkuar Kurtit ballafaqim në zgjedhje

AKTUALE



IZRAELI SULMON GAZËN
QENDRORE TEKSA SYNON
ZGJERIMIN E OFENSIVËS | F. 2

NISMË E RE ARABE PËR PAQEN? | F. 5

RAMA: NDËRMARRJA PUBLIKE
BANESORE, SHEMBULL I SUKSESIT
NË KRYEQYTET | F. 6

EKONOMI



ISH-GVERNATORI I BQK-së, FEHMI
MEHMETI: DY SFIDAT E KOSOVËS,
PAPUNËSIA DHE DEFICITI TREGTAR | F. 8

**KMDLNJ:
FATURAT
JONORMALE
TË RRYMËS,
PROKURORIA
E SHTETIT TË
HETOJË ME
URGJENCË!** | F. 7



**BE-ja
MIRËPRET
VENDIMIN E
SERBISË PËR
T'I NJOHUR
TARGAT RKS** | F. 3



**PDK-ja KËRKON NGA
KUSHTETUESJA VLERËSIM PËR
LIGJIN PËR FONDIN SOVRAN** | F. 8

SPORT



**SUPERLIGA NUK NDALET, MESJAVA
SJELL NDESHJE INTERESANTE** | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli sulmon Gazën qendrore teksa synon zgjerimin e ofensivës

GAZA, 26 DHJETOR - Forcat izraelite kanë bombarduar kampet palestineze të refugjatëve në Gazën qendrore të martën, thanë banorët. Duket se Izraeli po përgatitet ta zgjerojë ofensivën e tij tokësore në seksionin e tretë të territorit të pushtuar.

Izraeli është zotuar se do ta shtypë Hamasin - grup palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja - për shkak të sulmit vdekjeprurës që grupi kreu në jug të Izraelit më 7 tetor. Për javë të tëra forcat izraelite janë përfshirë në luftime të ashpra urbane në veri të Gazës dhe në qytetin jugor të Han Junisit, duke i shtyrë palestinezët të gjejnë strehim në skajet e territorit.

Pavarësisht prej presionit ndërkombëtar për armëpushim dhe thirrjeve të Shteteve të Bashkuara për ta shkurtuar numrin e viktimave në mesin e civilëve, kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu një ditë më herët paralajmëroi se lufta nuk

është afër fundit.

Lufta ka shkatërruar pjesë të mëdha të Gazës, duke vrarë më shumë se 20 600 palestinezë dhe duke detyruar të zhvendoset pothuajse e gjithë popullsia e territorit prej 2.3 milionë banorësh.

Si pasojë e sulmeve të Hamasit, në Izrael janë vrarë 1 200 persona dhe janë zënë rob 240 të tjerë.

Banorët e Gazës qendrore thanë më 26 dhjetor se gjatë natës ka pasur granatime dhe sulme ajrore në kapet Nuseriat, Magazi dhe Burej. Në këto kampe janë strehuar palestinezët e larguar nga shtëpitë e tyre gjatë luftës së vitit 1948 me Izraelin - dhe tani kampet janë mbushur edhe me të zhvendosurit si pasojë e luftës së fundit. “Bombardimet ishin shumë intensive”, tha Radwan Abu Sheitta, mësues palestinez që jeton në Burej.

Brigada e Kasamit, që është krahu ushtarak i Hamasit, tha se luftëtarët e tij kanë goditur një



tank izraelit në lindje të Burejit. Ky pretendim nuk ka mundur të konfirmohet në mënyrë të pavarur, por sugjeron se forcat

izraelite po lëvizin drejt kampit. Po ashtu, sulme nga ajri ka pasur edhe në lindje të kampit Nuseriat, thanë banorët. Izraeli është zotuar

se do ta vazhdojë luftën për t'i shkatërruar aftësitë ushtarake dhe qeverisëse të Hamasit, grupit që udhëheq Gazën që 16 vjet.

Azerbajxhani i dëbon dy diplomatë francezë



PARIS, 26 DHJETOR - Ministria e Jashtme e Azerbajxhanit ka urdhëruar dëbimin e dy diplomatëve francezë për shkak se “veprimet e tyre ishin në kundërshtim me statusin e tyre diplomatik”.

Ministria tha më 26 dhjetor se e ka thirrur në takim ambasadorin francez për t'i shprehur atij “një protestë të fuqishme ndaj veprimeve të dy punonjësve të Ambasadës së Francës”. Ata u urdhëruan të largohen nga vendi brenda 48 orëve.

Parisi nuk ka reaguar menjëherë ndaj këtij vendimi, të cilin nuk dihet se nga çfarë e nxiti. Tensionet mes këtyre dy vendeve janë rritur në vitet e fundit, pasi Franca e ka shtuar mbështetjen

për Armeninë fqinje dhe i ka shpeshuar kritikën për Bakun. Në nëntor, presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, e akuzoi Francën për nxitjen e konfliktit në Kaukaz duke e armatosur Armeninë.

Azerbajxhani dhe Armenia kanë zhvilluar dy luftëra për rajonin e kontestuar Nagorno-Karabak. Bakuja e rimori këtë enklavë në shtator pas një ofensive të lehtë kundër separatistëve armenë, të cilët e kishin kontrolluar atë për tri dekada.

Armenia dhe Azerbajxhani kishin thënë se një marrëveshje gjithëpërfshirëse e paqes mund të nënshkruhej deri në fund të këtij viti, por bisedimet e ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët mes dy ish-

republikave sovjetike kanë shënuar pak përparim.

Në nëntor, Aliyev nuk pranoi të ulet në tavolinën e bisedimeve me kryeministrin e Armenisë, Nikol Pashinyan, në Spanjë, për shkak të, siç kishte thënë, “qëndrimit të njëanshëm të Francës”.

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, dhe kancelari gjerman Olaf Scholz, pritej t'i ndërmjetësonin bisedimet bashkë me presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel.

Franca, e cila strehon një diasporë të madhe armene, është akuzuar kohë pas kohe nga Azerbajxhani se ia mban anën Armenisë në konfliktin territorial mes dy vendeve të Kaukazit.

India forcon marinën pas sulmeve në Oqeanin Indian

NEW DELHI, 26 DHJETOR - Marina e Indisë tha se ka dislokuar tri luftanije dhe një avion vëzhgues në Detin Arabik - që gjendet në veri të Oqeanit Indian - për ta “ruajtur praninë parandaluese” pasi së fundi ka pasur një serie të sulmeve ndaj anijeve.

Tri luftanije, si dhe avioni vëzhgues i llojit P8I, janë dislokuar “pas sulmeve të fundit në Detin Arabik”, u tha në deklaratën e marinës.

Uashingtoni ka akuzuar Teheranin se ka kryer një sulm me dron të shtunën ndaj cisternës Chem Pluto, 370 kilometra larg nga brigjet e Indisë, akuza që janë hedhur

poshtë nga Ministria e Jashtme e Iranit.

Kjo ishte hera e parë që Uashingtoni haptazi akuzoi Iranin se po sulmon anije, që kur ka nisur lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja - grupit radikal që mbështetet nga Teherani.

Anija që u sulmua, e që ishte në pronësi japoneze, të hënën u ankorua në portin indian të Mumbai. “Analizat nga zona ku ndodhi sulmi dhe mbetjet që u gjetën në anije tregojnë se sulmi u krye me dron”, tha marina e Indisë, duke shtuar se do të duhet të kryhen edhe analiza të



tjera.

Gjetkë, në Detin e Kuq, rebelët jemenas Huthi, që mbështeten

nga Irani, po ashtu kanë kryer një sërë sulmesh me dronë dhe raketa në solidaritet me

palestinezët në Gazë, ku Izraeli po lufton me radikalët e Hamasit.

Rebelët Huthi kanë detyruar kompani të mëdha të transportit detar që t'i ndryshojnë rrugët e tyre të tregtisë për shkak të sulmeve.

Nju-Deli, po ashtu, ka rritur përpjekjet për t'i luftuar sulmet e piratëve në Gjirin e Adenit, pasi piratët somalezë morën anijen MV Ruen muajin e kaluar.

India tha, po ashtu, se një anije në pronësi bullgare ishte marrë nën kontroll nga piratët somalezë më 16 dhjetor teksa po lundronte afër ishullit jemenas të Sokotratit.

Avokati i Popullit: Ligjin për Zgjedhje do ta dërgojmë në Kushtetuese

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Avokati i Popullit, Naim Qelaj, në një konferencë për medie të martën, ka paralajmëruar se Ligjin për Zgjedhjet do ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese. Qelaj para gazetarëve tha se lidhur me këtë i ka dërguar letër edhe presidentes Vjosa Osmani. “Unë i kam njoftuar të gjithë të pranishmit në mënyrë publike që jemi duke e shqyrtuar mundësinë e nënshtrimit të vlerësimit të kushtetutshmërisë të këtij ligji në raport me listat zgjedhore të subjekteve politike, ngaqë logjikisht si dhe në aspektin praktik Avokati i Popullit konsideron se është e domosdoshme...”, ka thënë ai, duke shtuar se Ligji për Zgjedhje ka kaluar në seancë pa një diskutim publik dhe pa e përfshirë një aspekt të rëndësishëm, atë të barazisë gjinore. Ai shtoi se ia kanë dhënë mundësinë Qeverisë dhe Kuvendit që deri në afatin e ushtrimit të kërkesës në kushtetutshmërisë të bëhet amendamenti i ligjit. Avokati i Popullit tha se vendi këtë vit u ballafaqua me situata të ndryshme, duke përfshirë edhe atë të sigurisë në veri të vendit. Qelaj ka bërë me dije se gjatë vitit 2023 kanë pranuar mbi 1 500 ankesa nga qytetarët dhe institucionet e ndryshme.

BE-ja mirëpret vendimin e Serbisë për t'i njohur targat RKS

ai nuk specifikoi nëse targat e veturave do të mbulohen me letra ngjitëse kur ta kalojnë kufirin, praktikë që aktualisht zbatohet. Për çështjen e lëvizjes së lirë, Kosova dhe Serbia kishin arritur marrëveshje më 2011 në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga blloku evropian. Para praktikës së letrave ngjitëse, automjetet me targa RKS detyroheshin të merrnin targa provuese në kufirin me Serbinë, që vlenin 60 ditë dhe kushtonin 5 euro. Por, më 20 shtator të vitit 2021 Qeveria e Kosovës vendosi masën e reciprocitetit, që detyroi edhe shoferët nga Serbia ta kalonin të njëjtën procedurë për të hyrë në Kosovë. Por, kjo masë nxiti pakënaqësi në mesin e popullatës serbe në Kosovë, të cilët bllokuan rrugët që çonin në pikëkalimet kufitare me Serbinë, në Jarinjë dhe Bërnjak. Për t'i ulur tensionet, me ndërmjetësimin e bllokut, më 30 shtator 2021 u arrit marrëveshja e përkohshme për targat. Kjo marrëveshje, që kishte për qëllim të ishte në fuqi për gjashtë muaj derisa grupet punuese të Kosovës dhe të Serbisë të gjenin një zgjidhje afatgjatë, bëri që shoferët me targa të Kosovës dhe me ato të Serbisë të vendosnin letra ngjitëse në simbolet shtetërore në targa sa herë që kalonin kufirin e këtyre dy shteteve.

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Bashkimi Evropian e ka cilësuar hap pozitiv drejt normalizimit të raporteve vendimin e Serbisë që brenda territorit të saj ta lejojë qarkullimin e lirë të veturave me targa të Kosovës - RKS - Republika e Kosovës. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, tha se pret që Kosova të ndërmarrë një vendim të ngjashëm dhe tha se kjo dëshmon se përparimi në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Prishtinës dhe Beogradit “është i mundur”. “Ne mirëpresim vendimin e Serbisë që zyrtarisht t’i njohë targat e automjeteve RKS të lëshuara nga Kosova. Ky vendim është hap pozitiv në zbatimin e Marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit, por edhe zotimeve të mëparshme në kuadër të dialogut për lirinë e lëvizjes. Kjo dëshmon se përparimi në procesin e normalizimit të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë është i mundur. Po ashtu, është hap i duhur drejt integritetit më të mirë evropian të Ballkanit Perëndimor, që në fund përfitues do të jenë qytetarët e rajonit. Ky vendim hap rrugën për heqjen e plotë të regjimit të letrave ngjitëse [sticker]. BE-jani pret që Kosova të përgjigjet në mënyrë të ngjashme”, tha Stano përmes një përgjigje me shkrim. Më 25 dhjetor, shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, kumtoi lajmin se nga 1 janari i vitit 2024 veturave me targa RKS do t’u mundësohet lëvizja e lirë në territorin e Serbisë. Megjithatë,

Haxhiu kërkon të punohet me seriozitet për parandalimin e kontrabandës në burgje

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Ministrija e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, së bashku me drejtorin e Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, të martën kanë mbajtur takimin e fundvitit, në të cilin kanë marrë pjesë drejtorët e burgjeve, në të cilin është diskutuar për punën, sfidat dhe të arriturat gjatë vitit 2023. Në fjalën e saj, ministrija Haxhiu kërkoj të punohet me seriozitet për parandalimin e kontrabandës në burgje, ngritjen e sigurisë, krijimin e kushteve dhe për respektimin e të drejtave të të burgosurve. Më tutje ministrija Haxhiu shprehu mbështetje për Shërbimin Korrektues të Kosovës në aspektin ligjor dhe atë financiar, ndërsa kërkoi që t’u jepet mbështetje edhe grave të punësuar në institucionet korrektuese. Ndërsa drejtorët e burgjeve kanë raportuar për arritjet, sfidat dhe synimet të cilat janë përkthyer me planin e punës dhe realizimin e strategjive dhe planifikimeve për vitin 2024. Sipas tyre, çështje shqetësuese mbetet trajtimi i të burgosurve të cilët kanë vendim për trajtim psikiatrik. Drejtorët shprehën vullnetin që me përkushtim të pakursyer dhe përgjegjësi të plotë t’i përmbushin obligimet në përputhje me përgjegjësitë e tyre.



Opozita e quan 'propagandë të lodhur' sondazhin që LV-në e nxori fituese, i kërkon Kurtit ballafaqim në zgjedhje

Në kohën kur po flitet mundësia për zgjedhje të parakohshme në vend, ka nisur edhe realizimi i sondazheve të ndryshme për të parë se si qëndrojnë partitë politike. Një sondazh i tillë është realizuar së fundmi nga UBO Consulting, sipas të cilit, Lëvizja Vetëvendosje kryeson në vend të parë me 48.5 %, e dyta është Partia Demokratike e Kosovës me 18.2 %, e treta Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.9 %. Pas këtyre partive pason AAK-ja me 6.8 për qind. Ndaj këtij sondazhi ka pasur reagime të deputetëve të LV-së dhe anëtarëve të saj, të cilët e kanë shpërndarë këtë sondazh në profilet e tyre në rrjete sociale. Opozita këtë sondazh e ka quajtur "propagandë të lodhur" dhe i ka kërkuar Kurtit ballafaqim në zgjedhje

**EPOKA
ERE**
Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Në kohën kur po flitet mundësia për zgjedhje të parakohshme në vend, ka nisur edhe realizimi i sondazheve të ndryshme për të parë se si qëndrojnë partitë politike. Një sondazh i tillë është realizuar së fundmi nga UBO Consulting, i cili është publikuar të hënën në mbremje në "RTV Dukagjini" e, sipas të cilit, Lëvizja Vetëvendosje kryeson në vend të parë me 48.5 %, e dyta Partia Demokratike e Kosovës me 18.2 %, e treta Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.9 %. Pas këtyre partive pason AAK-ja e cila rezultojnë të ketë 6.8 për qind. Sipas këtij sondazhi, nëse këto zgjedhje do të mbaheshin të dielën, atëherë LV-ja do të kishte 53 deputetë në Kuvend,

PDK-ja 20, edhe LDK-ja 20, AAK-ja 7 deputetë, kurse minoritetet 20 deputetë të cilët i ka të rezervuar. Ndaj këtij sondazhi ka pasur reagime të deputetëve të LV-së dhe të anëtarëve të saj, të cilët e kanë shpërndarë këtë sondazh në profilet e tyre në rrjetet sociale. Por opozita nuk është pajtuar me këtë sondazh. Nënkrjetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka theksuar se nëse kryeministri është vërtet i kënaqur me sondazhet, atëherë le ta provojë në zgjedhje. "Hajde shkojmë në zgjedhje. Edhe ashtu, prej korrikut të kemi lutë me e shpërnda Kuvendin. Çohu shkojmë në zgjedhje, edhe e merr vesh tamam se qysh i ke numrat edhe sa janë të kënaqur qytetarët me qeverisjen tënde, e cila do të shkoj n'histori si më e dështuara ndonjëherë!", ka

shkruar Çitaku në "Facebook". Këtë sondazh nuk e ka pritur mirë as LDK-ja. Kryetari i saj, Lumir Abdixhiku, ka thënë se kjo është një propagandë e lodhur. Ai ka paraqitur rezultatet e një sondazhi në pesë komuna që është bërë nga LDK-ja, e që flet ndryshe nga sondazhi i UBO Consulting. "Një propagandë e lodhur. Tash e dy muaj, Lidhja Demokratike e Kosovës ka porositur një seri sondazhesh, më të mëdha në historinë e anketimeve në Kosovë. Deri më tani, kanë përfunduar mbi 17,000 anketa vetëm në regjionin qendër. Rekord anketimesh këto për të siguruar saktësi të paprecedentë statistikore. Në pyetjen se, nëse zgjedhjet nacionale mbahen këtë të diel, për cilën parti do të votonit, rezultatet për LDK, të marra deri më tani vetëm për 5 qytete

në regjionin qendër janë: Prishtinë 35%, Lipjan 42%, Podujevë 35%, Obiliq 36% dhe Fushë Kosovë 34%", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ai ka thënë se anketa në këtë nivel po bëhen gjithandej Kosovës dhe ato do të publikohen me kohë. "Do t'i publikojmë vetëm për LDK-në sepse duam të ruajmë korrektësinë ndaj palëve tjera. Këto matje u janë prezantuar tashmë strukturave udhëheqëse të partisë, në takime të brendshme. Nuk kemi dashur t'i bëjmë publike meqë i kemi konsideruar si mjete të orientimit tonë. Të dhënat si këto, mbresëlënëse, ndonëse vetëm për një regjion, ishin shenjë e qartë e rrugëtimit tonë. Lajmi, ndonëse i komunikuar vetëm brenda, duket se ka arritur të marr jehonë. Dhe në këtë arritje jehone, ka aktivizuar propagandën", ka thënë lideri i LDK-së.

Ai ka thënë se në këtë panik e frikë nuk dëshiron të flasë as për kredibilitetin e kompanisë që në zgjedhjet e fundit lokale, një natë para votimeve, e kishte vendosur LDK-në në vend të tretë në Prishtinë. "As për mediumin (RTV Dukagjini) që vazhdon të besojë se

vetëprofecia e sondazheve do të funksionojë sërish. E kotë. Ndryshimi i vërtetë po vjen. Me të dhe fundi i propagandës", ka theksuar Abdixhiku.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj këtij sondazhi. Haradinaj ka theksuar se dikush po ka para që të paguajë sondazhe derisa qytetarët përballen me shtrenjtimin e energjisë elektrike dhe të artikujve ushqimorë. "Shtrenjtim enorm i rrymës e i gjithë artikujve elementarë ushqimor. Kosto e jetesës e papërbalueshme për më shumë se gjysmën e popullsisë, e dikush po ka para për të pagua sondazhe e rezultatit e tyre! Një hulumtim i thjeshtë i opinionit publik sot kushton prej 25-50 mijë euro! Prej nga këto para?! Më e pakta do të duhej që të interesohej Prokuroria, sa paguajnë dhe prej nga i kanë paratë! Sot që është ditë feste e që do të duhej të kishte një garë se kush ka ide e plane më të mira për mirëqenien e popullatës që është në zgrip të ekzistencës, kemi luftë sondazhesh e propagandash! Nuk mund të ketë dedikim më të mjerë në një ditë feste se sa lufta me sondazhe të blera!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Nismë e re arabe për paqen?



Sipas disa njoftimeve, Egjipti ka gati një plan paqeje për t’i dhënë fund luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit. Kajroja luan një rol ndëmjetësues në këtë konflikt, ndërkohë luftimet në Rripin e Gazës vazhdojnë

KAJRO, 26 DHJETOR - Egjipti, me gjasë, ka gati një plan me disa faza për t’i dhënë fund luftës në Rripin e Gazës, njoftojnë disa medie arabe. Sipas televizionit saudit Ashark, në fazën e parë bëhet fjalë për të arritur një ndalim të luftimeve për të paktën dy javë. Në këtë fazë duhet të lirohen edhe 40 pengjet e mbajtura nga Hamasi, kurse Izraeli duhet të lirojë 120 të burgosur palestinezë. Ky raportim u referohet “burimeve të informuara” që nuk përmenden më tej. Në fazën e dytë bëhet fjalë për një dialog kombëtar palestinez nën përkujdesjen e Egjiptit. Ky pasazh i referohet rivalitetit mes dy grupeve më të mëdha të

organizuara palestineze, Fatahut të presidentit Mahmoud Abaz dhe Hamasit islamist, që nga Izraeli, ShBA, BE, Gjermania e disa vende arabe kategorizohet si organizatë terroriste. Faza e tretë parashikon një armëpushim të plotë dhe një marrëveshje të zgjeruar për këmbimin e pengjeve dhe të burgosurve. Në fund ky plan, sipas të dhënave të raportuara, parashikon tërheqjen e plotë të ushtrisë izraelite nga Rripi i Gazës. Deri më tani nuk ka njoftime zyrtare për këto plane. Dihet se kreu i Hamasit islamist, Ismail Hanija, ka qenë më parë me një delegacion në Egjipt për bisedime. Egjipti e sheh veten në

rolin e ndërmjetësuesit në këtë konflikt. Ushtria izraelite ka gjetur ndërkohë kufomat e pesë pengjeve në një rrjet tunelesh në pjesën veriore të Rripit të Gazës. Ushtria bëri me dije se kufomat e tre ushtarëve dhe dy civilëve që u rrëmbyen nga Hamasi më 7 tetor janë gjetur në një sistem tunelesh shumë të gjerë dhe të thellë në zonën e refugjatëve Xhabalia.

Luftime në Khan Junis

Ndërkohë ushtria izraelite vazhdon luftimet në Rripin e Gazës pa ndalur duke u përqendruar në jug të rajnit.

Sipas të dhënave, luftimet kryesore përqendrohen në një “bastion tjetër të Hamasit, Khan Junis”, ka bërë me dije një zëdhënës i ushtrisë izraelite, Jonanathan Conricus, për televizionin “Fox News”. Në një takim të kabinetit qeveritar izraelit, kryeministri Netanjahu është shprehur se “lufta do të jetë e gjatë”. Ai pranoi se lufta kërkon “një çmim shumë të lartë”. Por Izraeli do të vazhdojë “me të gjithë fuqinë, deri në fund, deri në fitore, derisa të arrijmë të gjitha qëllimet tona”, ka thënë Netanjahu. Ushtria izraelite më parë kishte bërë me dije se vetëm nga e premnja ishin vrarë 14 ushtarë të tjerë në Rripin e Gazës. Ndërkohë kryeministri izraelit Netanjahu hodhi poshtë raportimet, sipas të cilave, Izraeli nën presionin e ShBA-së ka hequr dorë nga zgjerimi i luftës në Liban. “Kam parë publikime të pavërteta, që pretendojnë se ShBA-ja na ka penguar dhe na pengon në misionet në rajon”, tha Netanjahu. “Kjo nuk është e vërtetë. Izraeli është një shtet sovran”. “Wall Street Journal” kishte raportuar se Bideni e kishte bindur Netanjahun të mos sulmojë milicët e Hizbollahut në Liban. Kurse në një njoftim të Shtëpisë së Bardhë, Bideni, në telefonatën me Netanjahun, kishte biseduar për “qëllimet dhe fazat” e aksionit ushtarak izraelit. Bideni kishte theksuar “nevojën kritike” që të mbrohet popullata civile dhe mbështetësit e ndihmave humanitare dhe se ka rëndësi që të lejohen civilët të largohen nga zonat e luftës. /DW/

Rekord i koronarografive në Klinikën e Kardiologjisë

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, i shoqëruar edhe nga drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, morën pjesë në ngjarjen e shënimit të punës rekord të ofrimit shërbimeve shëndetësore për qytetarët gjatë vitit 2023 në Klinikën e Kardiologjisë. Ministri Vitia u informua nga drejtori i Klinikës së Kardiologjisë, dr. Lulzim Kamberi, për përparimin pozitiv që gjatë këtij viti në Klinikën e Kardiologjisë janë realizuar 4 050 koronarografi, shifër kjo që shënon një rritje impresionuese prej 1 121 koronarografish më shumë se në vitin paraprak. Po ashtu, janë bërë 3 458 stentime dhe 2 205 procedura të stentimeve. Gjithashtu, ministri Vitia u njoftua edhe për numrin e vizitave ambulantore në këtë klinikë, ku brenda këtij viti janë

ofruar 16 733 shërbime ambulantore në ambulancat specialistike në Klinikën e Kardiologjisë. 2 669 më shumë se në vitin e kaluar. Ministri Vitia e vlerësoi përkushtimin dhe angazhimin e palodhur të stafit të Klinikës së Kardiologjisë dhe potencoi se me qëllim të zvogëlimit të listës së gjatë të pritjes dhe jo vetëm, Ministria e Shëndetësisë ka paraqitur planin e veprimit për Kardiologjinë Invazive në Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit, plan ky i buxhetuar në 4,612,110.85 euro. Ky plan përfshin një investim të rëndësishëm në infrastrukturë dhe personel, duke synuar rritjen e numrit të procedurave invazive kardiake, rritjes së numrit të kardiologëve interventë, infermierëve dhe stafit mbështetës, si dhe orarit të ri.



Policia fillon fushatën "Festo me zemër, jo me armë"

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren, me rastin e festave të fundvitit, është duke zhvilluar një fushatë vetëdijesuese në zonën e përgjegjesisë. Gjatë këtyre aktiviteteve,

përpos shpërndarjes së fletëpalosjeve me këshilla për vetësiguri, në disa lokacione të cilat janë më të frekuentuara ka vendosur edhe posterë të cilët bëjnë thirrje vetëdijesuese te qytetarët me moton: "Festo

me zemër, jo me armë" (sa më pak armë, më pak tragjedi). Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren u bënë thirrje të gjithë qytetarëve që të kenë kujdes të shtuar, ta respektojnë ligjin duke iu përmbajtur rregullave

dhe duke u sjell me kujdes ndaj njëri-tjetrit në mënyrë që të ndikohet në zvogëlimin e numrit të lëndimeve dhe pasojave nga përdorimi i armëve dhe mjeteve të tjera piroteknike.



Fillon implementimi i nismës për ndarjen e bursave të diasporës për studentët e UP-së

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Qerim Qerimi, ka mirëpritur në takim Fitim Bozhdaraj, filantrop shqiptaro-amerikan, me të cilin ka biseduar rreth mundësisë së ofrimit të bursave nga diaspora për studentët e Universitetit të Prishtinës.

Fitim Bozhdaraj po angazhohet për bursa dyvjeçare për studentet e UP-së të cilat do t'i dhurojë në ditëlindjen e tij më 26 dhjetor 2023.

Dy bursa studentore, me një vlerë të përbashkët prej 2 000 eurosh, janë ofruar nga Bozhdaraj dhe do të dhurohen në emër të familjes së tij në formë donacioni.

Një bursë vjetore prej 1 000 eurosh do t'i dhurohet një studenteje të shkencave kompjuterike, për nder të Ajsa Bozhdaraj.

Bursa tjetër në vlerë prej 1 000 eurosh do të dhurohet për nder të Mujë Bozhdaraj, për një student të mjekësisë.

Rektori Qerimi ka vlerësuar



gatishmërinë e Bozhdarajt, njëkohësisht ka ofruar ndihmën e UP-së për ta zgjeruar atë në të ardhmen, duke zhvilluar një projekt të veçantë që do të

mundësojë që edhe anëtarët e tjerë të diasporës sonë ta mbështesin arsimimin e të rinjve në Kosovë.

Rektori Qerimi dhe Bozhdaraj janë

pajtuar për të punuar së bashku për krijimin e një databaze e cila do ta ofrojë strukturën dhe burimet informative të nevojshme për ta nisur mbështetjen e diasporës për

studentët e UP-së. "Rinia e fuqishme është e ardhmja e Kosovës. Rinia që largohet nga Kosova lë Kosovën pa një të ardhme. Ne duhet ta inkurajojmë talentin teknologjik dhe mjekësor për të ndërtuar një të ardhme në Kosovë dhe t'u ofrojmë çdo mundësi për këtë. Me këtë iniciativë shpresoj të frymëzoj anëtarë të tjerë të diasporës për të dhënë bursa", ka theksuar Bozhdaraj.

Universiteti i Prishtinës ka ndërmarrë edhe iniciativa të tjera për përfshirjen e diasporës, duke krijuar mundësi të reja për ta. Në këtë drejtim, brenda faqes zyrtare të UP-së është lansuar sektori "Diaspora", ku ofrohen mundësi të veçanta për të rinjtë tanë në diasporë për t'iu bashkuar UP-së. Fitim Bozhdaraj është një absolvent i Universitetit të Michiganit dhe Shkollës së Menaxhimit Kellogg dhe ka një karrierë të dëshmuar në fushën e financave dhe teknologjisë.

Ngrihet aktakuzë kundër një të dyshuari për krime lufte në Kosovë



PRISHTINË, 26 DHJETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ka ngritur aktakuzë në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin Special, kundër D. M. Prokuroria Speciale njofton se ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri D. M. (serb), ish-gardian i Burgut të Prishtinës dhe Lipjanit, gjatë periudhës së luftës në Kosovë më 1998-1999, në Burgun e Prishtinës dhe të Lipjanit, në cilësinë e personit zyrtar dhe në bashkëkryerje edhe me zyrtarë të tjerë të burgjeve, ka vepruar në kundërshtim dhe ka shkelur rregullat e të drejtës ndërkombëtare gjatë kohës së luftës, përkatësisht konfliktit të armatosur.

Prokuroria njofton se gjatë gjithë kësaj periudhe kohore në mënyrë sistematike i kishin maltretuar të burgosurit shqiptarë, duke i torturuar në mënyrë ç'njerëzore me mjete të ndryshme, veprime këto të sanksionuara sipas ligjeve vendore, zakoneve të luftës dhe Konventave Ndërkombëtare të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë. Me këto veprime i pandehuri D. M. në bashkëkryerje ka kryer veprën penale "Krime lufte kundër popullatës civile" nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së. Po i njëjti akuzohet edhe për veprën penale "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve", nga neni 366, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Rama: Ndërmarrja Publike Banesore, shembull i suksesit në kryeqytet

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vizituar Ndërmarrjen Publike Banesore, duke theksuar se është shembull i suksesit në kryeqytet. "Me një përkushtim të pamohueshëm, punonjësit e

Ndërmarrjes Publike Banesore arritën një rezultat të shkëlqyer gjatë vitit 2023. Sot gjatë vizitës në ndërmarrje, kryeshefi ekzekutiv, Artan Berisha, na tregoi për një rritje të të hyrave prej 88 %, një sukses i madh në krahasim me vitin 2022. Në

bashkëpunim me NPB-në gjatë këtij viti u rinovuan 10 objekte të qendrave të mjekësisë familjare, 6 institucione arsimore, shkolla dhe çerdhe, dhe shumë objekte kolektive në Prishtinë. Në vitin 2024 na presin super projekte", ka thënë Rama.



KMDLNj: Faturat jonormale të rrymës, prokuroria e shtetit të hetojë me urgjencë!

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 DHJETOR - “Faturat për rrymë të muajit dhjetor për shumicën e qytetarëve dallojnë shumë nga ato të muajit të kaluar. janë 100 % e më shumë më të larta. Në ndërkohë askush nuk ka njoftuar për rritje eventuale të çmimit të energjisë elektrike sikur që edhe temperaturat nuk kanë qenë të larta për të shpenzuar energji shtesë. Po në të njëjtën kohë serbët dhe banorët tjerë të veriut të Kosovës vazhdojnë të mos i paguajnë faturat për rrymën e shpenzuar sikur që rrymën e shpenzojnë pa asnjë kufizim”, është thënë në reagimin e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj). Sipas KMDLNj-së, Qeveria e Kosovës në rastin konkret po zbaton standarde të dyfishta duke i favorizuar serbët e veriut pasi ua paguan rrymën dhe duke i ndëshkuar konsumatorët e rregullt me një rritje aq të madhe dhe për këtë as që ka reaguar. “KMDLNj ka kërkuar nga qytetarët e Kosovës t’i bëjnë publike faturat e këtij muaji duke i krahasuar me ato të muajit paraprak sikur edhe të paraqesin kundërshtim në KEDS për këto fatura që janë thjesht vjedhje e parasë nga buxheti, edhe ashtu shumë i



rënduar i shumicës së familjeve në Kosovë. Në çdo vend normal kjo vjedhje klasike përmes faturave të rrymës do të ishte mundësi e artë për opozitën që fuqishëm të kundërshtojë ndërsa te ne vetëm kishte reagime sporadike të

deputetëve. Për këtë plaçkitje legale deputetët e Kuvendit të Kosovës është dashur të thërrasin seancë të jashtëzakonshme ndërsa qytetarët e Kosovës është dashur të reagojnë fuqishëm përmes një aktivizmi qytetar

kundër KEDS, KES/CO dhe ZRrE-së. E keqja e gjithë kësaj është se ZRrE, si Rregullator i Energjisë Elektrike asgjë nuk ka ndërmarrë për mbrojtje të interesit të qytetarëve të Kosovës por se ka mbrojtur gjithmonë interesin e kompanive

gllabëruese si KEDS dhe KES/CO”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Sipas këtij institucioni, në vendet ku bëhet një politikë e përgjegjshme dhe ku deputetët vërtet përfaqësojnë interesat e qytetarëve/votuesve të tyre, më së paku që do të ndodhte do të ishte dorëheqja apo shkarkimi i ministrisë përkatëse, mbase edhe rënia e qeverisë. “Këtu, përveç revoltës së shprehur nëpër rrjetet sociale nuk ka kundërshtim të vendosur dhe të organizuar qytetarë andaj edhe po legalizohen këto vjedhje të qytetarëve. Të gjithë jemi dëshmitarë se edhe në vendet me një standard dhe ekonomi shumë më të zhvilluar si Franca, Gjermania, Italia, Hungaria etj. për shtrenjtim shumë më të vogël ka pasur protesta shumëditëshe dhe përballje të qytetarëve me policinë deri kur shteti ka pranuar fajin dhe është thyer në pozitat e mëparshme”, thuhet tutje në reagim. Sipas KMDLNj-së, në Kosovë, përveçse qeveria diskriminon qytetarët në baza etnike, disave ua paguan rrymën që 23 vjet, ndërsa të tjerët i penalizon dhe i vjedh gjithashtu që 23 vjet, diskriminimi bëhet edhe në pagesën e shërbimeve të tjera si uji, plehrat dhe kanalizimi, tatimi në pronë etj. dhe me këtë dukuri askush nuk merret seriozisht.

KESCO: Tarifat e energjisë elektrike nuk janë rritur, shumë konsumatorë po ngrohen me rrymë

PRISHTINË, 26 DHJETOR - KESCO ka njoftuar konsumatorët dhe opinionin publik se nuk ka pasur rritje të tarifave fundore. “Tarifat e energjisë elektrike janë rishikuar dhe rritur afërsisht 15 % krahasuar me tarifat 2022-2023, me vendim të ZRrE-së, më 1 prill 2023. Rritja e vlerës së faturave në këtë muaj dimri është rezultat i rritjes së konsumit të energjisë elektrike, veçanërisht te konsumatorët që e përdorin energjinë elektrike për ngrohje”, thuhet në reagimin e KESCO-s. Më tej në reagim thuhet se konsumimi i energjisë elektrike në vlerë më shumë se 800 kWh në muaj faturohet me tarifë më të lartë, ashtu siç paraqiten në çdo faturë te konsumatorëve. “Efekti tjetër i rritjes së vlerës së faturës është që vitin e kaluar në të njëjtën periudhë, Qeveria e Kosovës ka subvencionuar konsumatorët që kanë kursyer energji elektrike. Disa konsumatorë po marrin fatura më të larta sepse po përdorin masivisht energjinë elektrike për ngrohje”, theksohet në reagim. KESCO ka shtuar se janë të përkushtuar për kursim dhe shfrytëzim efikas të energjisë

elektrike, duke ndarë këshilla praktike për secilën kategori të konsumatorëve, pikërisht për ta mbrojtur konsumatorin dhe sistemin elektrik nga këto ngarkesa. “ZRRE ka ndërtuar një strukturë tarifore të ndarë në blloqe shpenzuese. Kështu, nëse ju si konsumator familjar konsumoni deri në 800 kWh, atëherë i nënshtroheni vetëm dy blloqeve, ditën dhe natën, të cilat në dimër fillojnë nga ora 22:00 deri në orën 7:00. Gjatë ditës çmimi është 7.79 cent për kWh, ndërsa natën rreth 57 për qind më i lirë, pasi llogaritet me 3.34 cent për kWh. Megjithatë, çmimet ndryshojnë për konsum mbi 800 kWh. Nëse një konsumator konsumon 1600 kWh, atëherë pjesa deri në 800 kWh llogaritet me çmimet e lartpërmendura. Ndërsa pjesa e mësipërme llogaritet me 2 tarifa të tjera: ajo e larta gjatë ditës që shkon në 14.45 cent për kWh ose 85.5 për qind më shtrenjtë, dhe ajo e natës 6.81 cent për kWh ose gati 104 për qind më e shtrenjtë se shpenzimi nën 800 kWh. Të gjitha këto çmime janë të shënuara në çdo faturë për konsumatorët”, është theksuar në reagimin e KESCO-s.



Ish-guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti: Dy sfidat e Kosovës, papunësia dhe deficitit tregtar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Instituti Hulumtues për Ekonomi dhe Financa (IHEF) ka mbajtur të martën konferencën e parë për medie në të cilën ka folur drejtori ekzekutiv Fehmi Mehmeti, ish-guvernatori i BQK-së dhe ekspertët e këtij instituti, Mejdi Bektashi dhe Medain Hashani. Gjatë kësaj konference ata kanë dhënë rekomandime për 'Prioritetet ekonomike të qeverisë për vitin 2024'.

Drejtori i IHEF-së, Fehmi Mehmeti, ka folur për zhvillimet ekonomike në vend dhe ka dhënë rekomandime se si duhet vepruar nga ana e Qeverisë së Kosovës. Ai ka thënë se dy sfidat e Kosovës janë papunësia dhe deficitit tregtar. Sipas tij, qeveria duhet t'i ftojë ekspertët dhe të merren me krijimin e një politike zhvillimore, duke përfshirë edhe ndërtimin e një zone ekonomike. "IHEF synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin e Kosovës përmes promovimit, analizës dhe aplikimit të ideve, zhvillimit të koncepteve dhe dijës. Kosova, si shtet i ri, ka nevojë për ide dhe plane konkrete që do të jenë një mundësi më e mirë për institucionet, si ato publike ashtu edhe ato private. IHEF përbëhet nga hulumtues shkencorë dhe hulumtues të pavarur shkencorë. Situata jo e



favorshme politike ka ndikuar që në Kosovë ta tërheqë vëmendjen e lidershit politik nga ekonomia. Situata ekonomike momentale është pothuajse e pafavorshme për investitorët e huaj në mënyrë që t'i orientojnë investimet e tyre në Kosovë", ka theksuar Mehmeti, duke shtuar se Kosova momentalisht është në një udhëkryq të papërshtatshëm në aspektin ekonomik.

Ai ka theksuar se në bazë të të dhënave të cilat janë publikuar nga Banka Botërore, rritja ekonomike e Kosovës në vitin 2022 ka qenë e planifikuar të jetë 3.5%, mirëpo në bazë të të

dhënave të përditësuara në vitin 2023 ka një rritje ekonomike prej 3.7% të GDP-së. "Bilanci tregtar i Kosovës është një sfidë mjaft e lartë e Kosovës. Nëse i kthehemi retrospektivës, ekonomia e Kosovës paraluftës dhe pasluftës asnjëherë nuk ka pasur bilanc tregtar pozitiv. Ndërsa njëri nga treguesit kryesor të zhvillimit ekonomik të një ekonomie nacionale është bilanci tregtar. Në vitin 2023 bilanci tregtar i Kosovës pritet të jetë mbi 4 miliardë euro", është shprehur Mehmeti. Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të ketë para vetes prioritete nga të cilat do

të duhej të zgjidheshin problemet në ekonomi. "Qeveria për të pasur zhvillim ekonomik dhe rritje ekonomike, nevojitet që qysh në fillim t'i formojë grupet punuese në nivel nacional të ekspertëve të ekonomisë që ta krijojnë strategjinë e zhvillimit ekonomik në nivel nacional. Në kuadër të strategjisë së zhvillimit ekonomik, nevojitet që të parashohë politika zhvillimore në fushën e krijimit të kushteve për investitorët potencialë. Politikat zhvillimore duhet të jenë të fokusuar në tërheqjen e investimeve të huaja. Për të tërhequr investime të huaja

nevojitet që të shpallet një zonë ekonomike në nivel nacional, e cila do ta orientojë buxhetin e shtetit në këtë zonë në mënyrë që investitorëve t'u krijohen kushtet e favorshme për të investuar në Kosovë", ka thënë ai. Sipas Mehmetit, qeveria duhet ta krijojë edhe diplomacinë ekonomike, e cila, sipas tij, do të ishte promotore kryesore e promovimit të zonës ekonomike tek investitorët e jashtëm për t'i informuar lidhur me kapacitetet të cilat i kanë për të investuar në Kosovë.

Ndërkaq Mejdi Bektashi ka thënë se duhet të kemi strategji të mirëfilltë zhvillimore ekonomike dhe jo të kemi një qasje orientuese vetëm te skemat sociale.

E Medain Hashani ka thënë se Instituti Hulumtues për Ekonomi dhe Financa nuk do të merret me politikë, por do të dalë me rekomandime konkrete për të pasur zhvillim ekonomik në vend dhe për hapjen e mundësisë së gjenerimit të vendeve të reja të punës, duke theksuar se viti 2024 do të jetë vit sfidues për Kosovën.

Instituti Hulumtues për Ekonomi dhe Financa është themeluar së fundi nga ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe nga ekspertë të fushave të ndryshme.

Fushëveprimtaria e IHEF fokusohet në zhvillim ekonomik, social, avokim e lobim, integritet evropian dhe komunikim.

PDK-ja kërkon nga Kushtetuesja vlerësim për Ligjin për Fondin Sovran

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Partia Demokratike e Kosovës ka dërguar për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për Fondin Sovran.

Deputeti i PDK-së, Ferat Shala, tha se qeveria përmes këtij ligji po orvatet të vendosë një superstrukturë për të krijuar pabarazi dhe për të hapur linja të tjera të kontrollit mbi asetet publike. "Ne sot po e fillojmë këtë proces politik dhe jemi të bindur se do të duhej të kthehej apo të suprimohej ky ligj tashmë i miratuar dhe t'i kthehemi normalitetit ekonomik të vendit, sepse kjo qeveri po orvatet që me ligje të tilla diskriminuese të pabarabarta të kapë resurset, asetet dhe ndërmarrjet të cilat de fakto dhe de jure i menaxhon vetë", shtoi Shala.

PDK-ja vlerëson se me Ligjin për Fondin Sovran po krijohet një institucion jashtë parimeve të sundimit të ligjit dhe kërkesa për

vlerësimin e këtij ligji e pamundëson dekretimin e tij nga ana e presidentes.

Ndërsa avokati Faton Fetahu tha se deputetët e grupit parlamentar të PDK-së qysh në fillim kanë paralajmëruar se një nismë e tillë është jokushtetuese, pasi disa ndërmarrje do t'i nënshtrohen kësaj ndërmarrje, duke krijuar kështu pabarazi juridike dhe ekonomike. "Në tërësi kemi evidentuar, kemi vlerësuar se 11 nene të këtij ligji janë të papajtueshme me të paktën 7 nene të Kushtetutës dhe i tillë është edhe neni i cili flet për rolin investues të Fondit Sovran dhe krijimin e ndërmarrjeve, të cilat janë si ndërmarrje private, të cilat do t'i mbështesë Fondi. Pra, në këtë mënyrë krijon monopol në treg, sepse Fondi Sovran do të zgjedhë dy ndërmarrje private sipas dëshirës së tij, pa kushte dhe pa kriterë, do të investojë", theksoi Fetahu.



Dëshmitë e Viktor Çamit: Faktori K dhe Enver Hoxha



Nga: Daut DAUTI

Viktor Çami (1930-2023), i cili vdiq para tre ditëve në Angli, ka qenë njeri i dijshtëm, i dashur dhe patriot. Viktori ka lindur në Vjenë nga nëna austriake kurse babai i tij ka qenë Aziz Çami. Siç shihet nga mbiemri, Azizi ka qenë nga Çamëria i lindur në fshatin Janjar të rrethit të Konispolit. Në vitin 1920, Azizi ka qenë komandant i forcave shqiptare në Luftën e Vlorës – pasi që kishte të kryer akademinë ushtarake në Torino të Italisë. Më vonë i bashkohet KONARE-s (Komitetit Revolucionar) së bashku me Hasan Prishtinën, Fan Nolin etj. Në vitin 1931, Azizi ka qenë njëri nga atentatorët ndaj Ahmet Zogut – atentati që ndodhi në shkallët e Operës në Vjenë. Në vitin 1943, komunistët e vranë Azizin në Tiranë me që ishte anëtar i rëndësishëm dhe nga komandantët kryesorë të forcave të Ballit Kombëtar.

Nga kjo vrasje, biri i tij Viktori, së bashku me nënën, detyrohen të kthehen në Vjenë. Pas Luftës së Dytë Botërore, Viktori punësohet në BBC. me që ishte njohës i mirë i disa gjuhëve, përfshirë shqipen dhe gjuhën amtare (gjermanishten), në vitet 1976-1990 Viktori ka punuar si përkthyes dhe analist në Ambasadën amerikane në Vjenë dhe në Londër. Me fjalë tjera, Viktori ka qenë njeriu pranë

informatave që janë filtruar nga diplomatët amerikanë në Vjenë dhe në Londër. Duke u bazuar në këtë njohuri, e ka shkruar librin Letra nga mërgimi që janë dëshmi interesante dhe të rëndësishme. Më poshtë mund ta lexoni një fragment nga ky libër që ka të bëjë me mendimet e tij për demonstratat e vitit 1981 në Kosovë dhe jehonën e tyre në Shqipëri dhe në botë:

Kosova dhe qëndrimi i shtetit shqiptar më 1981

Të gjithë analistët janë dakord se kyçi i gjithë enigmës shqiptare, në çdo fazë të zhvillimeve, është dhe mbetet çka njihet si “Faktori K”, d.m.th. Kosova. Pas heqjes së Rankoviqit dhe “liberalizimit” në Kosovë (pikërisht në atë kohë që mbyllej seksioni shqiptar i BBC-së) dhe që kishte natyrisht objektiva strategjike të caktuar, pritej një ndikim në Shqipëri, herët ose vonë, sidomos pas prishjes me Kinën. E kundërta ndodhi: Faktori K shpërtheu fuqishëm më 1981. “Zëri i popullit” botoi artikullin: “Pse u përdor forca policore në Kosovë”? Filloi të “digjet stralli” nën këmbët e titistëve. Reagimi në botë ishte: në fillim habi, pastaj nervozizëm, alarm, gati panik. Ishin bërë llogaritë pa hanxhinë! Po na prishej balanca e vendosur në Jaltë! Vetëm atëherë filloi bota (njëlloj si Lindja edhe Perëndimi) për herë të parë ta vështrojë

Shqipërinë seriozisht.

Duhej rivlerësuar gjendja. Duhej vendosur çfarë qëndrimi të mbahej ndaj këtij zhvillimi të ri dhe krejt të papritur. U vendos (njëlloj në Lindje si në Perëndim) se ngjarjet në Kosovë nuk ishin në interes të fuqive të interesuara: u denoncuan si shprehje të “nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar”. U këshilluan kosovarët të rrinë urtë dhe të ulin kokën, të nënshtrohen. Pozitat e Beogradit u mbështetën prej të gjithëve, hapur ose jo hapur: ishin shqiptarët fajtorë! Kur u mbajt Kongresi i tetë i PPSH-së më 1981 (i fundit për Enver Hoxhën) parulla e vëzhguesve ishte: “Kosova zien ... E gjithë bota i ka drejtuar sytë kah Tirana”. Pritej se ç’do të thoshte “shqiptari më i madh i të gjitha kohërave”, se çfarë qëndrimi do të mbante Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë.

A mund të më thoni, mikun im i dashur – në këto rrethana – se Enver Hoxha mund të kishte hequr qoftë edhe një presje të vetme në pjesën përkatëse të raportit të tij? Ai e dinte fare mirë se presionet do të intensifikoheshin në maksimum, po të mos hiqte dorë nga përkrahja e tij për lëvizjen kosovare. Ai e dinte fare mirë efektin që do të kishte një bllokadë ekonomike (e pashpallur, natyrisht) mbi ekonominë shqiptare dhe mbi perspektivën e rritjes, nivelin e jetesës, gjendjen e brendshme e të tjera. Ai e dinte


fare mirë se do të shtoheshin problemet ekonomike dhe sociale dhe, rrjedhimisht, se mund të dilnin në sipërfaqe edhe tensione politike, sidomos pas largimit të tij nga skena (nuk ishte në gjendje shëndetësore të mirë qysh atëherë). Kjo dihej edhe këtej. Por, ai dhe shteti shqiptar nuk mund ta ndryshonin pozicionin as edhe një centimetër. E vetmja gjë që mund të bënin ishte të prisnin derisa bota e jashtme (Lindje dhe Perëndim) të ndryshonte qëndrimin, derisa të ndryshonin kushtet politike objektive në botë. Enver Hoxha nuk mund t’u thoshte kosovarëve nga tribuna e Kongresit: “Ore djema, ulni kokën dhe shtrohuni si bagëti se s’kemi si t’ju ndihmojmë, nuk ja delni dot me kërkesat tuaja, sado të drejta”. Dhe, për të gjitha këto u penalizuan Shqipëria dhe shqiptarët. Kjo është mënyra se si interpretohen ngjarjet në botë. Politika është thjesht kalkulim i interesave, konjunkturave dhe i balancës së forcave.

[...]

Ndoshta më mashtron kujtesa, por kam përshtypjen se artikulli me titull: “Pse u përdor dhuna policore në Kosovë?” u botua shtatë ditë pas shpërthimit në Prishtinë. Do të thosha se partia dhe shteti shqiptar nuk mund të reagonin menjëherë, duke dhënë kështu përshtypjen se ishin të përgatitur. Ekzistenca apo jo e divergjencave në udhëheqjen

shqiptare ishte natyrisht diçka që preokuponte në atë periudhë edhe të gjitha qarqet e interesuara kudo në botë. Është për t’u habitur si nuk ka pasur deri më sot asnjë informacion publik mbi këtë çështje. Diku duhet të ketë një farë dokumentacioni për këto çështje jashtëzakonisht të rëndësishme; dikush në dijeni të fakteve duhet të ketë hapur gojën pas gjithë këtyre viteve. Mister! Enigmë!!

Për sa i përket vërejtjes suaj: “asnjë reagim zyrtar i Tiranës për gjakosjen e Kosovës në OKB”, mund të vë në dukje vetëm se OKB-ja nuk ka mandat të merret me çështje të brendshme të një shteti e, përveç kësaj, dihet se OKB-ja edhe në atë periudhë dominohej nga fuqitë e mëdha anëtare të Këshillit të Sigurimit. Dihet edhe se ngjarjet në Prishtinë nuk u pritën aspak me kënaqësi nga asnjë prej këtyre fuqive. Do të thosha bile se efekti i këtyre ngjarjeve shkaktoi gati një panik të vërtetë në disa qarqe. Ju e dini fare mirë se demonstratat u denoncuan nga pothuajse i gjithë shtypi perëndimor si “manifestime të nacionalizmit, separatizmit dhe irredentizmit shqiptar”. Kosovarët u denoncuan (pikërisht si thoni edhe ju) si “elementë destabilizues!” Gjendja ndryshoi vetëm më 1989, në kohën e ngjarjeve të Trepçës kur nuk ishte më e mundur të mbulohej dielli me shoshë! /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Chandler, sërish MVP në Superligë

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Java e 14 në Prince Caffë Superligë dhuroi sfida interesante, që u vendosën në sekondat e fundit të takimeve. Peja fitoi derbin ndaj Bashkimit në udhëtim, ku basketbollisti më i mirë të "verdhezinjtë" ishte Jay Jay Chandler me 25 pikë, 11 kërcime dhe nëntë asistime. Chandler e kishte

indeksin e ndeshjes 35 apo më të lartin në këtë xhiro. Proton Cable Prizreni shënoi fitore të rëndësishme, duke mundur Istogun për të kaluar në vendin e gjashtë në renditje, ku te prizrenasit më i dalluari ishte Isaiah Kelly. Ai e përfundoi ndeshjen me 27 pikë, 12 kërcime e katër asistime. Sigal Prishtina po

vazhdon me formë të lartë, ndërsa kësaj radhe mundi Vëllaznimin. Te prishtinasit u dalluan Steven Davis dhe Shaheed Davis. Steven e mbylli ndeshjen me 20 pikë, 11 kërcime dhe tri asistime, kurse Shaheed me 23 pikë, shtatë kërcime dhe katër asistime. Me formë të lartë po vazhdon edhe Trepça, që

shënoi fitore ndaj Golden Eagle Yllit në udhëtim. Te mitrovicasit më i miri ishte Darnell Egde me 17 pikë, katër kërcime e shtatë asistime. Top pesëshja: Jay Jay Chandler (Peja), Isaiah Kelly (Proton Cable Prizreni), Steven Davis (Sigal Prishtina), Shaheed Davis (Sigal Prishtina), Darnell Egde (Trepça).



Superliga nuk ndalet, mesjava sjell ndeshje interesante

PRISHTINË, 26 DHJETOR - Në mesjavë, përkatësisht të mërkurën dhe të enjten, zhvillohet xhiroja e 15-të në Prince Caffë Superligë, që është e fundit për vitin 2023. Sfida e parë zhvillohet ndërmjet vendit të fundit, Istogut dhe lideres Trepçës. Istogasit kanë një fitore dhe 13 humbje, kurse mitrovicasit kryesojnë me 12 fitore e dy humbje. Takimi i dytë i së mërkurës zhvillohet në mes të Sigal Prishtinës dhe Proton Cable Prizrenit. "Bardhekaltrit" janë në formë të lartë me nëntë fitore e pesë humbje, ndërsa prizrenasit renditen në vendin e gjashtë me pesë fitore e nëntë humbje. Të enjten do të përballen Golden Eagle Ylli me Bashkimin. Therandasit kanë tetë fitore e gjashtë humbje,

ndërsa prizrenasit kanë katër fitore e dhjetë humbje, andaj të dyja skuadrat synojnë fitoren, që të kenë plasman sa më të mirë në garat e rregullta. Peja - Vëllaznimi është sfida e fundit që, njëkohësisht, pritet të jetë më interesantja e kësaj xhiroje. Kampionët e Kosovës janë në vendin e dytë me dhjetë fitore e katër humbje, ndërsa kuqezinjtë kanë shtatë fitore dhe shtatë humbje, duke u renditur në vendin e pestë.

SUPERLIGA - Java 15

Të mërkurën takohen:
17:00 Istogu-Trepça
19:30 Sigal Prishtina-Proton Cable Prizreni

Të enjten takohen:
19:00 Golden Eagle Ylli-Bashkimi
19:00 Peja-Vëllaznimi



Ferizaj paraqet Kiqinën



FERIZAJ, 26 DHJETOR - Sokol Kiqina është futbollisti më i ri i skuadrës së Ferizajt. 21-vjeçari ishte së fundmi pjesë e skuadrës së Erzenit në Shqipëri. Kiqina kishte mbrojtur ngjyrat e Llapit, ndërsa karrierën e ka filluar në klubin e qytetit, KF Ferronikeli. Në sezonin 2021/22, sa ishte pjesë e Ferronikelit, Kiqina kishte shënuar 4 gola në 3 ndeshje të zhvilluara. Kiqina llogaritet një ndër lojtarët më perspektiv në futbollin vendor.

Ai ka debutuar në Superligën e Kosovës ende pa i mbushur 18 vjeç. "Me këtë transferim ne hapim afatin kalimtar, duke premtuar ardhje të tjera kualitative, në pozicionet që i kemi evidentuar si të nevojshme që të kryejmë transferime. Na pret një rrugëtim i gjatë në pranverë, andaj do ta shfrytëzojmë në maksimum periudhën për ta krijuar një ekip edhe më kompakt e konkurrues", thuhet në njoftimin e Ferizajt.


Kololli paraqitet te Baseli

BASEL, 26 DHJETOR - Benjamin Kololli iu bashkua të martën Baselit si transfer i lirë. Futbollisti nga Kosova është larguar nga Japonia pas dy vjet e gjysmë ku luajti për skuadrën

Shimizu S-Pulse. "Mezi pres që së shpejti ta vesh fanellën kuqeblu dhe jam shumë krenar që së shpejti do të luaj në 'Joggeli'. Kam luajtur disa herë në këtë stadium, por tani

jam i lumtur që mund ta bëj këtë me tifozët e jashtëzakonshëm pas meje. Do të jap gjithçka për të pasur sukses me klubin. Unë tashmë e njoh trajnerin dhe mezi pres

të takoj të gjithë stafin dhe bashkëlojtarët së shpejti", ka deklaruar Kololli. 31-vjeçari ka luajtur 24 ndeshje për Përfaqësuesen e Kosovës dhe ka shënuar katër gola.



Shefi i Mercedesit: Gabimi më i madh ishte makina e vitit 2022

STUTT GART, 26 DHJETOR - Kur nisi sezoni 2022 në Formula 1 dhe në fuqi hynë rregullat për makinat e reja, Mercedesi ishte larg asaj që prisnin të gjithë. Makina që kishte dominuar për gati 10 vjet nuk ishte më, duke i lënë skenën Red Bullit, që prej dy sezonesh është e

paarritshme nga rivalët. Duke folur për këtë situatë, Toto Wolff, shefi i Mercedesit, ka thënë: “Gabimi më i madh i karrierës time si drejtues ishte makina Mercedes e vitit 2022. Gabuam mënyrën se si do ta ndërtonim makinën e këtij sezoni dhe më pas humbëm

rrugën që duhej të bënim për ta sistemuar situatën. Fakti që konfirmuam këtë koncept edhe për vitin 2023 ishte gabimi i dytë, por e mbrojtëm këtë koncept, pasi fituam në Brazil me Russellin. Çdo skuadër do ta kishte marrë si bazë atë fundjavë në Brazil për sezonin

e ri. Më shumë se gjysma e skuadrës ishte e bindur se gjërat po sistemoheshin. Mendoj se shumë punonjës motivohen kur shohin se shefi i tyre ka ambicie të mëdha, por ndonjëherë i kaloj limitet. Atëherë duhet të pi një çaj kamomili. Nëse të dielën pas



garës tregohem i ashpër me punonjësit, atëherë kthehem në fabrikë dhe kërkoj ndjesë. Kjo është pjesë e një lideri”, ka deklaruar Wolff.

Shqipëria në turne miqësor para ‘Euro 2024’, marrin pjesë edhe këto kombëtare

TIRANË, 26 DHJETOR - Kombëtarja e Shqipërisë pritet të marrë pjesë në një turne miqësor si pjesë e përgatitjeve të skuadrës kuqezi përpara finaleve të “Euro 2024”. Lajmi qarkullon prej ditësh në Algjeri ku, përveç organizatorëve dhe skuadrës shqiptare, do të marrin pjesë Afrika e Jugut dhe Bolivia. Jo një apo dy ndeshje, por një turne të plotë miqësor. Është ky një opsion për kombëtaren e Shqipërisë në përgatitjet e saj përpara finaleve të “Euro 2024”. Bëhet fjalë për një turne që do të zhvillohet në Algjeri gjatë muajit mars, kur janë edhe datat e lira të FIFA-s. Përveç organizatorëve, do të marrin pjesë Shqipëria, Afrika e Jugut dhe Bolivia. Në Federatën Shqiptare të Futbollit nuk e zyrtarizojnë pjesëmarrjen e skuadrës kuqezi, por mediet algeriane flasin me siguri për këtë turne. E sigurt është që në federatë po punojnë prej javësh për të



siguruar të paktën dy kundërshtarë për skuadrën e Silvinjos përpara aventurës në “Euro 2024”. Duke parë nivelin e kundërshtarëve në Grupin B të Kampionatit Evropian, tekniku kuqezi do të pëlqente rivalë të fortë për miqësoret e marsit. Opsionet për të luajtur me Zvicrën apo Turqinë, dy skuadra

gjithashtu të kualifikuara në Euro 2024, u sfumuan shpejt për shkak të agjendës së tyre. Në këtë mënyrë turne miqësor në Algjeri duket se është një mundësi e mirë për përgatitjet e kombëtares kuqezi përpara Kampionatit Evropian që do të zhvillohet verën e ardhshme në Gjermani.

Fitojnë Denveri dhe Bostoni, Donqiqi realizon 50 pikë për Dallasin



DENVER, 26 DHJETOR - Ndeshje “big” të luajtura ditën e Krishtlindjeve në NBA, ku në fushë zbritën kampionët e basketbollit, në takime interesante. Kampionët e Denverit fituan me rezultat 120-114 ndaj Golden States. Të gjithë titullarët e Denverit realizuan mbi

10 pikë, ku u dalluan Murray me 28 pikë e Jokiqi me 26 pikë e 14 rebounde. Fitoi edhe Bostoni, që mundi me shifrat 126-115 lakersat në fushën e këtyre të fundit. Porzingis me 28 pikë e 11 rebounde ishte shënuesi më i mirë për Celticsin, ndërsa 40 pikët e 13

reboundet e Davisit mbetën për statistikë për lakersat. Fitore të rëndësishme korri Miami, që falë 31 pikëve të Vazques, mundi Philadelphian (119-113). Zhgënjën ekipi i Milwaukeees, që u mund me rezultat 129-122 nga New Yorku, ndeshje me rivalitet, ku shkëlqeu Brunsoni, autor i 38 pikëve. Lillard e Antetokounmpo realizuan 64 pikë së bashku, por që s’mjaftuan. Jashtë fushës fitoi ekipi i Dallasis, që mundi me rezultat 128-114 Phoenixin, sfidë ku dallimin në parket e bëri Luka Donqiqi, autor i 50 pikëve dhe 15 asistimeve.

REZULTATET	
New York - Milwaukee	129-122
Denver - Golden State	120-114
Lakers - Boston	115-126
Miami - Philadelphia	119-113
Phoenix - Dallas	114-128

SHKURT

11-shja më e shtrenjtë në botë

Portali gjerman “Transfermarkt” ka publikuar 11-shën më të shtrenjtë në botë. Treshja e sulmit udhëhiqet nga Haaland dhe Mbappe që vlejnë 180 milionë euro dhe Vinicius Junior që vlen 150 milionë euro. Ndërsa mesfusha përbëhet nga ylli i Realit, Bellingham, që vlen 180 milionë euro dhe Rodri 110 milionë euro. Pjesë e mesfushës më të shtrenjtë është edhe dyshja e Arsenalit, Saka - Rice. Treshja mbrojtëse është Gvardiol, Ruben Dias dhe Saliba, ndërsa portieri më i shtrenjtë është ai i Milanit, Mik Maignan.

Kamberi largohet nga Slaven Belupo

Futbollisti nga Kosova Florian Kamberi është larguar nga Kroacia. Skuadra e Slaven Belupos ka njoftuar se ka shkëputur kontratën me 28-vjeçarin, të cilin e kishte paraqitur në fillim të muajit tetor. Klubi kroat i ka dëshiruar Kamberit suksese në karrierë dhe e ka falënderuar për kontributin e tij. Kamberi në tetor iu bashkua ekipit kroat si lojtar i lirë dhe firmosi kontratë deri në fund të këtij edicioni. Mirëpo ai u largua nga Slaven Belupo pas vetëm gjashtë paraqitjeve në të gjitha garat apo 176 minutave lojë. Kamberi ishte transferuar te Slaven Belupo pasi i kishte skaduar kontrata me ekipin nga Anglia, Huddersfield. Ai gjatë karrierës ka luajtur edhe për shumë skuadra, si Winterthuri, St. Galleni, Sheffield Wednesday, Aberdeeni, Hiberniani, Glasgowi, Grasshoppersi e Karlsruhe.

Bayerni ofron 100 milionë euro për Araujon

Bayern Munchen synon ta përmirësojë repartin e mbrojtjes dhe ka vetëm një emër në mendje, Ronald Araujo. I datëlindjes 1999, në pronësi të Barcelonës, uruguaiani duket se ka magjepsur Thomas Tuchel, i cili po përgatit investimin e çmendur të verës. Sipas asaj që raporton “Mundo Deportivo”, klubi gjerman do të kishte gati një çek prej 100 milionë eurosh për t’ia rrëmbyer lojtarin klubit katalanas. Araujo ka një kontratë me Barcelonën deri më 30 qershor 2026.

Atletico refuzon ofertën e Juves për De Paulin

Juventusit ka nisur punën për merkaton e janarit, me skuadrën torineze që po mendon ta përforcojë mesfushën. “Zonja e Vjetër” ka bërë ofertën zyrtare për Rodrigo De Paul, por së fundmi italianët kanë marrë përgjigje negative nga Atletico Madridi. Spanjollët nuk dëshirojnë të heqin dorë nga lojtari por, sipas medieve italiane, Juventusit nuk do të heqë dorë dhe po përgatit një ofertë të re. “Bardhezinjtë” kërkojnë me çdo kusht ta përforcojnë repartin e mesfushës pas pezullimit të Pogba dhe Fagiolit, ndërkohë që një tjetër emër shumë i përfolur është Philipps.

Kimmich në ‘radarin’ e Cityt

Joshua Kimmich te Manchester City nuk është një opsion i pamundur. Mesfushori gjerman ka një kontratë me Bayern Munchenin deri më 2025, këtë

periudhë ka refuzuar shpesh ta rinovojë kontratën aktuale, për këtë arsye largimi i tij diskutohet në shtëpinë e Bayernit, pasi drejtuesit e klubit nuk dëshirojnë

ta humbasin falas. Jo vetëm kaq por, sipas medieve, Kimmich nuk ka një raport të mirë me trajnerin Tuchel, me këtë të fundit që ka dhënë bekimin e tij për një largim

të mundshëm. Kimmichi është një nga pinjollët e Pep Guardiolas, një lojtar që tekniku portugez e vlerëson shumë. Kimmich shihet nga

Guardiola si një opsion në rast se largohet Philippsi. Mesfushori anglez nuk po gjen hapësira te Manchester City, pëlqen të transferohet te Juventusit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Elsa” Sh.p.k – Pejë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Shfrytëzimin e Gurëve Dekorativ-Gëlqerorëve në lokalitetin Kastrë – Zatriq, Komuna Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 15.02.2024 në ora 10:00 në Sallen e Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit, do të organizohet Debat Publik nga Kompania “Elsa” Sh.p.k – Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM.

<https://us05web.zoom.us/j/9321497099?pwd=a5TCsrpaOjax51NfsCvvIEMU1oxQS8.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Elsa” Sh.p.k – Pejë, për Shfrytëzimin e Gurëve Dekorativ-Gëlqerorëve në lokalitetin Kastrë – Zatriq, Komuna Rahovec.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Bright Future Academy” SH.P.K. me seli në Gjiilan, me pronar Zenel Krasniqi dhe Ilir Kastrati ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b. 811464502 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Bright Future Academy” D.O.O. Gnjlane, sa vllasnikom Zenel Krasniqi i Ilir Kastrati donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811464502 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Bright Future Academy” L.L.C. with headquarters Gjiilan, with owner Zenel Krasniqi and Ilir Kastrati has come to the decision to quit its business: 811464502 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ademi Color” Sh.P.K. me pronar Besnik Ademin nga Vushtrria, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr.b UNIK: 811370593 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ademi Color” D.O.O. sa vlasnikom Besnik Ademi od Vuçiterna, donelo odluku o prestani rada sa nr.b. 811370593 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Ademi Color” L.L.C owver Besnik Ademi in Vushtrria, has come to the decision to quit its business: 811370593 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzon Bajrami shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit “Eqrem Çabej” Prishtinë.

- Metë Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Agron Loshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Besnik Hajdaraj nga Jabllanica e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Lendrit Pajaziti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Tafë Kelmendi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Elmira Ahmeti, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Xheladin Deda”.

- Flamur Musa, shpall te pavlefshme dëftesat e klasës: I,II,III,IV dhe diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani”.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

